



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR PUNËSIMIN E PUNONJËSVE TË PËRKOHSHËM ME KOHË JO TË PLOTË PUNE PËR MONITORIMIN E SUBJEKTEVE AUDIOVIZIVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Bazuar në ligjin 97/2013, i ndryshuar “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ligjin 10019, i ndryshuar “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përmbushje të detyrimit për monitorimin e subjekteve audiovizive gjatë fushatës zgjedhore për Kuvend që do të zhvillohen në datë 25 Prill 2021, do të rekrutojë 27 punonjës të përkohshëm me kohë jo të plotë pune në pozicionin “Monitorues”.

KRITERE PUNËSIMI PËR OPERATORË MONITORUES:

- Studentë të cilët janë në vazhdim ose kanë përfunduar studimet universitare në nivelin bachelor ose master. (preferohet dega gazetari)
- Të ketë aftësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.
- Të kenë aftësi të mira komunikimi, për të punuar në grup.
- Të ketë njohuri të paketës Microsoft Office, veçanërisht Excel.
- Të mos ketë qenë anëtarë i ndonjë partie politike në tre vitet e fundit.

DETYRAT FUNKSIONALE:

1. Monitorimi i programeve të subjekteve audio/audiovizive (edicione lajmesh, reklama, programe, etj)
2. Hedhja e të dhënave të monitorimit në programet specifike që zotëron AMA.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për pozicionin e punës monitorues:

- Kërkesë me shkrim për punësim.
- Curriculum Vitae (në formatin Europass).
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit.

- Fotokopje të diplomave të arsimimit ose vërtetim nga Universiteti përkatës që janë në ndjekje të nivelit të studimeve bachelor ose master.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.
- Formularin e deklarimit individual të nënshkruar (këtu bashkëlidhur)

PERIUDHA E PUNËSIMIT:

Marrëdhëniet financiare fillojnë më datë 18 Mars 2021 dhe ndërpriten në datë 26 Prill 2021

MËNYRA E PAGESËS:

Kategoria e pagës - IVB

MËNYRA E APLIKIMIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT DO TË JETË:

- Me anë të shërbimit postar në adresën e Autoritetit të Mediave Audiovizive: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010 Tiranë.
- Dorëzim në Zyrën e Protokollit të AMA-s, në adresën e mësipërme.
- Dërgim në postën zyrtare elektronike të AMA-s: info@ama.gov.al

AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE: 17 Shkurt 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

FORMULAR DEKLARIMI INDIVIDUAL

Deklaruesi: Z/Znj _____

Pozicioni për të cilin aplikoj: _____

Vendi i Punës: _____

Në vijim të njoftimit për punësimin e punonjësve të përkohshëm me kohë jo të plotë pune për monitorimin e subjekteve audiovizive gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021

Sot me datë ___/___/ 2021 nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se, _____ anëtar në partitë politike apo strukturat e tyre në tre vitet e fundit.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramentit.

Datë ___/___/_____

Nënshkruesi _____